



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 24 Dt. 13.02.2017

**“MIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI
ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “AFRIMI K” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, pikës 2,të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni”, për paisjen me autorizim të subjektit “AFRIMI K” sh.p.k, me propozim të A.B.U Drin- Bunë , miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore,Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “AFRIMI K”sh.p.k, me administrator **Z.Afrim DOBRUSHI**, për përdorim të burimit ujor **Përroi i Kalimashit** , për prodhim energjie elektrike në fshatin Kalimash, Njësia Administrative Malzi,Bashkia Kukës,Qarku Kukës .

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti **HEC Thanza** do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës së marrjes ; X – 44 43 009.2; Y- 46 57 351.4; Z - +566 m

Koordinatat e godinës së centrali: X – 44 44 114.6; Y –46 61 419; Z - +299m;

Koordinatat e pikës së shkarkimit : X – 44 44 114.6; Y –46 61 419; Z - +299m;

Prurja mesatare vjetore e burimit : Q mes= 0.64 m³/sek;

Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti: Q llog = 0.9 m³/sek ;

Prurja ekologjike: Qekol= 0.06 m³/sek;

Prurja që shkarkohet: 0.9 m³/sek.

2- Autorizimi i përdorimit të burimit ujor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e ketij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

Sekretari
Martin PLLUMBI



Kryetar
Paulin RADOVANI

